



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Arsimit dhe Shkencës    Ministria e Brendshme    Ministria e Punës dhe Shanseve të Barabarta    Ministria e Shëndetësisë

Nr. 4024 Prot,    Nr. 385/2 Prot,    Nr. 1613 Prot,    Nr. 4029 Prot,  
datë 02.8.2013    datë 02.09.2013    datë 04.09.2013    datë 10.9.2013

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET  
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS,  
MINISTRISË SË BRENDSHME,  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË  
DHE  
MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE  
TË BARABARTA

“PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN NË SHKOLLË TË TË GJITHË  
FËMIJËVE TË MOSHËS SË DETYRIMIT SHKOLLOR”

Mbështetur në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që më poshtë do të quhen “palë”, lidhin këtë Marrëveshje për bashkërendimin e punës për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor.

I. Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshjeje është:

1. Përfshirja e të gjitha institucioneve për ndjekjen e arsimit bazë nga të gjithë fëmijët e moshës së detyrimit shkollor.
2. Koordinimi i Drejtorive Arsimore Rajonale (DAR)/Zyrave Arsimore (ZA) dhe shkollave me njësitë bazë të qeverisjes vendore, Zyrrat e Gjendjes Civile, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Qendrat Shëndetësore për regjistrimin e fëmijëve në arsimin e detyruar.

## II. Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si qëllim identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor.

## III. Detyrime të përbashkëta

1. Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet punonjësve të ngarkuar me këtë përgjegjësi.
2. Palët organizojnë takime të përbashkëta, çdo gjashtë muaj, për të analizuar problematikat e konstatuara dhe për të gjetur zgjidhjet për to.
3. Palët i dërgojnë njera-tjetrës informacione në formë shkresore dhe/ose elektrike për problemet që lindin gjatë zbatimit të Marrëveshjes.

## IV. Detyrimet e palëve

### IV.1 Detyrimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ngarkon DAR/ZA-të dhe shkollat arsimi bazë me këto detyra:

1. DAR-i, për territorin ku nuk përfshihen ZA-të e veta dhe ZA-të, hartojnë një listë të vetme emërore të fëmijëve, që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhëm shkollor, duke ballafaquar të dy listat e ardhura nga zyra përkatëse e gjendjes civile dhe qendra përkatëse shëndetësore.
2. DAR dhe ZA u dërgon listën e parashikuar në pikën 1 të gjitha shkollave në juridiksion (publike dhe ato private) brenda muajit maj.
3. Në fund të periudhës së regjistrimit në shkollat publike, drejtorët e shkollave të arsimit bazë, publike dhe ato private u dërgojnë DAR/ZA-ve përkatëse listat emërore të fëmijëve të regjistruar në shkollat e tyre.

4. DAR/ZA-të hartojnë listën e fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollat bazë publike dhe ato private në jurisdiksionin e tyre.
5. DAR/ZA-ja, brenda muajit shtator, e dërgojnë listën e parashikuar në pikën 4, kryeplakut përkatës të zonës dhe inspektorit të policisë së zonës.
6. DAR/ZA-ja, deri me 15 tetor, i dërgon shkollave publike të dhënat e kryepleqve dhe të inspektorëve të policisë së zonës.
7. Shkollat publike identifikojnë fëmijët, që u përkasin zonës së tyre dhe deri në fund të muajit tetor të vitit të ri mësimor marrin përsipër regjistrimet e nxënësve dhe informojnë zyrtarisht DAR/ZA-në përkatëse.
8. DAR/ZA-të dhe shkollat bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e arsimit, për zbatimin e ligjit Nr 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", për detyrimin shkollor.

#### **IV.2 Detyrimet e Ministrisë së Brendshme**

Ministria e Brendshme ngarkon zyrat e gjendjes civile, kryepleqtë dhe inspektorët e policisë së zonës me këto detyra:

1. Zyra e gjendjes civile u dërgon në muajin prill DAR-eve, për territorin që nuk përfshihen ZA-të e veta dhe ZA-ve, listën emërore të fëmijëve, që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhëm shkollor, duke pasur parasysh datën e fillimit të vitit shkollor.
2. Kryeplaku gjen në listën e fëmijëve ende të paregjistruar, që i dërgohet nga DAR/ZA-ja, fëmijët që i përkasin zonës që mbulon dhe duhet të regjistrohen në klasën e parë në një shkollë të DAR/ZA-së. Emrat e fëmijëve shoqërohen me vendndodhjet e tyre.
3. Inspektorati i policisë gjen në listën e fëmijëve ende të paregjistruar, që i dërgohet nga DAR/ZA-ja, ata fëmijë që i përkasin zonës që mbulon dhe i dërgon DAR/ZA-së përkatëse emrat e fëmijëve, bashkë me vendndodhjet e tyre.

#### **IV.3 Detyrimet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëpërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, ngarkon Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel bashkie/komune me këto ka këto detyra:

1. Bashkëpunon me shkollat dhe ndihmon në identifikimin e fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor, por nuk e ndjekin shkollën.
2. Bashkëpunon me shkollat publike për regjistrimin e fëmijëve, që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor, por nuk e ndjekin shkollën, dhe informon zyrtarisht DAR/ZA-në përkatëse.

### 3.4 Detyrimet e Ministrisë së Shëndetësisë

1. Qendra përkatëse shëndetësore dërgon në muajin prill në Drejtorinë e Shëndetit Publik, nga e cila varet, listën e fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në një vit të caktuar shkollor, duke pasur parasysh datën e fillimit të këtij viti shkollor.
2. Drejtoria e Shëndetit Publik i dërgon DAR-it në muajin prill, për territorin që nuk përfshihet në ZA-të e veta dhe ZA-ve, listën emërore të fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në një vit të caktuar shkollor.

#### I. SHFUQIZIMI I AKTEVE

Çdo marrëveshje e mëparshme e lidhur mes palëve, që vjen në kundërshtim me këtë marrëveshje, shfuqizohet.

#### II. AFATI, NËNSHKRIMI DHE ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

1. Marrëveshja nënshkruhet për një afat katërvjeçar: Gusht 2013 deri Korrik 2017.
2. Marrëveshja nënshkruhet në katër kopje, në gjuhën shqipe dhe të barasvlershme.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet me kërkesën me shkrim të secilës prej Palëve nënshkruese, por vetëm pas njoftimit paraprak prej 30 ditësh.

Nënshkruar më 02 . 8 .2013.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

  
Myqerem TAFAJ

MINISTRIA E BRENDSHME

  
Flamur NOKA

MINISTRI I SHËNDETËSISË

  
Halim KOSOVA

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TË BARABARTA

  
Spiro KSERA